



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 6 / 16, DATË 30 / 10 / 2023**

**PËR**

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 6/4 DATË 19/4/2018, TË NDRYSHUAR ME  
VENDIMIN NR. 6/9, DATË 24/06/2020 TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE  
STRATEGJIKE**

Në mbështetje të Nenit 8, 9, 17, 18, 21, Kreut VII të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë,

**VLERËSOI:**

- Subjekti investues ka nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për ekonominë Kontratë Qiraje Nr. Rep 1961, Nr.729 kol, datë 14.06.2022, në të cilën specifikohet se sipërfaqja e dhënë me qira është 496.6 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) ha dhe afati i qiradhënies është 30 (tridhjetë) vite nga data e nënshkrimit.
- Subjekti investues propozon, që brenda një pjese të sipërfaqes së marrë me qira, të realizojë një park agrivoltaik me një fuqi të instaluar prej 78.4 MW, i cili nuk do të ndryshojë planin e biznesit të miratuar për aktivitetin bujqësor dhe zhvillimin e agroturizimit dhe as destinacionin e tokës bujqësore, por përkundrazi, duke shfrytëzuar resurset natyrore, do të shtojë dhe do të përmirësojë këtë aktivitet.
- Vlera e investimit të aktivitetit të shtuar që propozohet, do të jetë 47,485,200 (dyzetë e shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind) USD.

Në këto kushte, pasi shqyrtoi propozimin, dokumentacionin, si dhe vlerësimet e grupit operacional,

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDOSI:**

1. Titulli i Vendimit Nr. 6/4, datë 19/4/2018, të ndryshuar me Vendimin Nr. 6/9, datë 24/06/2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike, bëhet si më poshtë vijon:

*"Për miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji*

*berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit dhe të aktivitetit agrivoltaik në një sipërfaqe rreth 496.6 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”.*

2. Në Vendimin Nr. 6/4, datë 19/4/2018, të ndryshuar me Vendimin Nr. 6/9, datë 24/06/2020 të Komitetit të Investimeve Strategjike, bëhen shtesat si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1 të vendimit, pas fjalëve "si dhe zhvillimin e agroturizimit" shtohen fjalët "dhe të aktivitetit agrivoltaik".

b) Pas pikës 1 të vendimit, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

*"Aktiviteti agrivoltaik do të zhvillohet në sipërfaqen e përcaktuar në Aneksin 1 të këtij vendimi, sipërfaqe e cila ndodhet brenda gjurmës ekzistuese prej 496.6 ha të projektit të investimit, në parcelat me bonitet 7 (shtatë), 8 (tetë), 9 (nëntë), 10 (dhjetë) sipas vërtetimit nga DAMT. Në tokat bujqësore me bonitet 7 (shtatë) dhe 8 (tetë) aktiviteti lejohet vetëm duke vijuar aktivitetin e prodhimit bujqësor dhe në mënyrë të kombinuar. Në tokat me bonitet më të ulët nuk lejohet ky aktivitet”.*

c) Në pikën 4 të vendimit, pas germës 'c' shtohet germa 'ç' me këtë përmbajtje:

*“Miratimin në parim të së drejtës për realizimin e aktivitetit agrivoltaik në gjurmën e ilustruar në Aneksin 1 të këtij vendimi, me kusht që të zbatohen parashikimet e Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ato të VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar. Miratimi perfundimtar, do të jepet, pas ndryshimit të PDZRK Karavasta - Seman dhe verifikimit të përpuethshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e tokës”. Sipërfaqja bashkëlidhur këtij vendimi, i shtohet Aneksit 1 të Vendimi Nr. 6/4, datë 19/4/2018, të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe bëhet pjesë e pandashme e tij.*

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë që, në zbatim të VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, të propozojë në Këshillin e Ministrave vendimin për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të parkut agrivoltaik.
4. Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të Territorit", i ndryshuar dhe VKM Nr. 408, datë 15.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës, ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të iniciojë rishikim të PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, të miratuar me vendimin e KKT Nr. 3, datë 26.07.2018, të ndryshuar me Vendimin e KKT Nr. 3 datë 14.10.2020.
5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për amendimin e kontratës së qirasë të lidhur me subjektin investues dhe të çdo akti tjetër nënligjor, që mund të preket nga ky ndryshim.
6. Ngarkohet subjekti investues që të përfundojë realizimin e parkut agrivoltaik brenda 24 (njëzet e katër muajve), pas miratimit të ndryshimeve në PDZRK së Lagunës Karavasta dhe Lumit Seman, miratuar me Vendim te KKT-së Nr.3, datë 26.7.2018, të ndryshuar, dhe akteve rregullatore, nga institucionet e ngarkuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike. Në rast se subjekti investues nuk respekton këtë afat ky vendim humbet efektet juridike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

## PLANI I VEPRIMIT

### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, GOJI BERRY, KIVI, RRUSH, DARDHË, ETJ., SI DHE ZHVILLIMIN E AGROTURIZIMIT DHE TË AKTIVITETIT AGRIVOLTAIK NË NJË SIPËRFAQE RRETH 496.6 HA, NË ZONËN E KARAVASTASË, BASHKIA DIVJAKË”.

#### 1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

#### Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### 2. Hapat procedurale

Masa mbështetëse të miratuara janë si më poshtë vijon:

Masat mbështetëse	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza.  Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse  (Të specifikohet dhe baza ligjore ku mbështetet procedura)	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto

<p>Përdorimi i truallit prej 496.6 ha, në ZK. Nr.2085 në funksion të realizimit të projektit “Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit dhe të aktivitetit agrivoltaik në një sipërfaqe rreth 496.6 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”. Sipërfaqja prej 68.6 ha sipas aneksit 1 të miratuar do të përdoret për aktivitet agrivoltaik.</p> <p>-Nxjerrja e akteve nënligjore të nevojshme për aktivitetet agrivoltaike, në zbatim të Ligj Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.</p> <p>-Rishikim i PDZRK Karavasta për realizimin e aktivitetit</p>	<p>PO</p>	<p>MBZHR</p>	<p>AKPT</p> <p>MIE</p> <p>MBZHR</p>	<p>Plani i Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDKRZ) Karavasta -</p>	<p>Akti/aktet nënligjore për realizimin e aktivitetit agrivoltaik do duhet të jenë miratuar në Këshillin e Ministrave brenda muajit dhjetor 2023.</p> <p>Procesi i rishikimit të PDZRK fillon paralelisht</p>	
--	-----------	--------------	-------------------------------------	---	---	--

<p>agrivoltaik në zonë sipas aneksit të miratuar.</p>		<p>BASHKIA DIVJAKË</p>	<p>Seman, nuk ka parashikuar zhvillime me karakter agrivoltaik;</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të Territorit", i ndryshuar dhe VKM Nr. 408 datë 15.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, legjislacionit për mbrojtjen e tokës bujqësore, do të nevojitet rishikimi i PDZRK-së përpara aplikimit për lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit.</p>		<p>me iniciativën e MBZHR për propozimin në Këshillin e Ministrave të akteve nënligjore për realizimin e aktiviteteve agrivoltaike në zbatim të Ligj Nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar.</p>	
<p>Amendim i kontratës së qirasë dhe VKM Nr. 355 datë 20.04.2018 dhe VKM Nr. 619 datë 18.09.2019, nëse lind nevoja, sipas parashikimeve të këtij vendimi të Komitetit të</p>	<p>MFE</p>		<p>Referuar VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015</p>		<p>Pas miratimit të aktit/akteve nënligjore për aktivitetet agrivoltaike dhe rishikimit të PDZRK</p>	

Investimeve Strategjike.						
-----------------------------	--	--	--	--	--	--

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**